



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 janar 2013
Nr. ref: RK384/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI49/11

Parashtruesi

Ibrahim Sokoli

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev. nr. 362/2009, të 4 shkurtit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Ibrahim Sokoli, me banim në Kaçanik.

Vendimet e kontestuara

2. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 362/2009, i 4 shkurtit 2011.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Kërkesa ka për objekt ndërrimin e vendit të punës së parashtruesit nga punëdhënësi i tij gojarisht, pa kurrfarë vendimi me shkrim, si dhe ofrimi i vendit të ri të punës që nuk përputhet me përvojën dhe me kualifikimet profesionale të parashtruesit.

Procedura në Gjykatë

5. Më 14 prill 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 19 prill 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI-49/11, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI-49/11, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 25 janar 2012, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Komunës së Kaçanikut, Gjykatës Komunale në Kaçanik dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.
8. Më 5 dhjetor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve siç janë dorëzuar nga parashtruesi

9. Parashtruesi ka qenë në marrëdhënie pune në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik (në tekstin e mëtejshëm: QKMF), si teknik i dhëmbëve, që nga viti 1977.
10. Nga janari i vitit 2007, për shkak të sistematizimit të ri, QKMF në Kaçanik gojarisht, pa vendim me shkrim, njoftoi parashtruesin se do t'i ndërrohet vendi i punës. Parashtruesi u ankua në Këshillin drejtues të QKMF-së në Kaçanik.
11. Më 20 shkurt 2007, Këshilli drejtues i QKMF-së në Kaçanik, me Vendimin nr. 180, refuzoi kërkesën e parashtruesit dhe i ofroi atij që të zgjedhë njërin prej këtyre vendeve të punës: 1) asistent i stomatologut; 2) punëtor në sistemin operativ të informimit; dhe 3) vozitës.
12. Më 1 prill 2007, parashtruesit, pa vendim me shkrim, iu ndaluan të ardhurat si dhe në listat e punëtorëve, në rubrikën ku duhej të figuronte emri i tij, ishte shënuar me germa të mëdha PP, që nënkuptonte pushimin pa pagesë. Ndaj këtyre veprimeve, parashtruesi u ankua te Komisioni për ankesa në KK të Kaçanikut.

13. Komisioni për ankesa i KK të Kaçanikut nuk iu përgjigj parashtruesit brenda afateve të parapara ligjore. Parashtruesi paraqiti ankesë te Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMK).
14. Më 18 shtator 2007, KPMK-ja, me Vendimin 2081/07/07, *inter alia* përcaktoi: 1) aprovimin e pjesshëm të ankesës së parashtruesit të kërkesës, 2) kthimin e lëndës në rishqyrtim te Komisioni i Ankesave i KK të Kaçanikut, dhe 3) obligimin për Kryeshefin Ekzekutiv në KK të Kaçanikut për autorizimin e Komisionit për ankesa për vendosje në lëndën e parashtruesit të kërkesës.
15. Më 9 nëntor 2007, Komisioni Komunal për Ankesa, me Vendimin nr. 566/07, miratoi kërkesën e parashtruesit dhe e sistematizoi atë në pozitën e re, si teknik i mirëmbajtjes së makinave stomatologjike, që i përgjigjej përgatitjes profesionale së parashtruesit, porse vendimi në fjalë nuk u ekzekutua nga organi kompetent i KK të Kaçanikut.
16. Më 8 shkurt 2008, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Kaçanik, që (Aktgjykimi C. nr. 32/08, i 30 majit 2008) *inter alia* përcaktoi: 1) miratimin në tërësi të kërkesëpadiës së parashtruesit të kërkesës, 2) detyrim për KK të Kaçanikut që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vend të punës sipas përgatitjes profesionale, dhe 3) detyrimin për KK të Kaçanikut që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë të ardhurat personale duke filluar nga data 1 prill 2007.
17. Komuna e Kaçanikut paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër aktgjykimit të lartpërmendur. Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 1014/2008, i 12 marsit 2009) refuzoi si të pabazë ankesën e KK të Kaçanikut dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kaçanik.
18. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, Komuna e Kaçanikut parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila (Aktgjykimi Rev. nr. 362/2009, i 4 shkurtit 2011) pranoi revizionin e KK të Kaçanikut dhe ndryshoi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, gjegjësisht të Gjykatës Komunale në Kaçanik.
19. Gjykata Supreme *inter alia* arsyetoi:

“... nga shkresat e lëndës del se paditësi (Parashtruesi) ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura që nga viti 1973, dhe nga janari i vitit 2007, për shkak të sistematizimit të ri gojarisht i është treguar se do t'i ndërrohet vendi i punës pa kurrfarë vendimi me shkrim...paditësi i është ofruar vendi i punës asistent i stomatologjisë në sistemin operativ të operimit ose vozitës, ashtu që Drejtori i QKMF-së ka marrë vendim dhe paditësit ia kanë ndërruar vendin e punës si teknik i dhëmbëve duke marrë parasysh mundësitë buxhetore të cilat kanë lidhje me mbulesën e të ardhurave personale”.

“...nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike por gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit (Parashtruesit) është e bazuar. Kjo ngase ndërrimi i vendit të punës së paditësit është bërë sipas mundësive buxhetore lidhur me mbulesën e të ardhurave personale. Përveç kësaj nga provat që gjenden në shkresat e lëndës del se vendi i punës asistent i stomatologjisë ose punëtor në sistemin operativ të informimit të cilat vende i janë ofruar paditësit, niveli i pagës është i njëjtë me pagën e mëparshme në vendin e punës të paditësit në të cilin ka punuar dhe është në përputhje me dispozitën e nenit 11.1 të Urdhërësës Administrative nr. 2003/2 zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi shërbimin civil”.

“... pos këtyre fakteve paditësi (Parashtruesi) ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të caktuar gjer më 31.12.2006, të cilit janë paguar të ardhurat personale gjer më 01.04.2007, me ofrimin e vendeve të punës, nuk ka pranuar të nënshkruajë edhe kontratën e re 3-vjeçare për vazhdimin e marrëdhënies së punës pas përfundimit të kontratës së parë me pagë të njëjtë dhe sipas aftësisë profesionale të tij”.

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas revizionit të të paditurës (KK Kaçanik), ka ndryshuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe kësisoj ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.
21. Parashtruesi pretendon se, në mënyrë arbitrare, pa kurrfarë vendimi me shkrim dhe pa mbështetje ligjore, atij i janë ndaluar të ardhurat dhe në listat e punëtorëve, në rubrikën me emrin e parashtruesit, ishte shënuar me germa të mëdha PP, që nënkupton pushim pa pagesë.
22. Për më tepër, parashtruesi pretendon se vendet alternative të punës, që i janë ofruar nga organi punëdhënës, nuk i përgjigjen përgatitjes së tij profesionale.

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

23. Për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.
24. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
25. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, që përcakton:

*(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) Kërkesa është qartazi e bazuar*
26. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.
27. Gjykata vëren se parashtruesi kishte iniciuar procedurë administrative dhe se KPMK-ja kishte miratuar pjesërisht kërkesën e tij, ndërsa Komisioni për Ankesa i Komunës së Kaçanikut, po ashtu, kishte miratuar kërkesën e parashtruesit, porse vendimi i Komisionit për Ankesa nuk ishte zbatuar nga Komuna e Kaçanikut.
28. Gjykata vëren se parashtruesi kishte iniciuar procedurë kontestimore, duke paraqitur padi në Gjykatën Komunale të Kaçanikut, e cila dha vendim të favorshëm për parashtruesin. Vendimi i Gjykatës Komunale në Kaçanik u vërtetua nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, pas ankesës së palës së paditur, gjegjësisht KK të Kaçanikut.
29. Gjykata, po ashtu, vëren se Gjykata Supreme e Kosovës ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, me ç'rast konkludoi se gjykatat e instancës më të ulët kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale, sepse ndërrimi i vendit të punës së

parashtruesit është bërë sipas mundësive buxhetore dhe se të njëjtit i janë ofruar vende të reja të punës me nivel të njëjtë me pagën e mëparshme, mirëpo parashtruesi nuk kishte pranuar të nënshkruante kontratën e re.

30. Në rastin konkret, nga dokumentet e dorëzuara, Gjykata konkludon se Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar lëndën si nga aspekti i çështjes së fakteve, ashtu edhe nga aspekti i të drejtës materiale. Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës ka shtjelluar raportin ndërmjet punëdhënësit dhe punonjësit, si dhe ka dhënë interpretimin e saj të dispozitave ligjore që rregullojnë raportin ndërmjet punëdhënësit dhe punonjësit.
31. Përkitazi me këtë, parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, duke shpjeguar se si dhe pse është kryer ndonjë shkelje, ose duke ofruar dëshmi për të vërtetuar se i është shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me Kushtetutë.
32. Gjykata, në mënyrë të ngjashme, ka vendosur në Rastin KI127/11, parashtrues i kërkesës Ardian Hasani, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 219/2009, të 10 qershorit 2011, të dhënë nga Gjykata më 24 maj 2012.
33. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve. Gjykata Kushtetuese edhe me këtë rast thekson se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (*Shih, mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65*).
34. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo në mënyrë të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta. Si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë dëshmitë para vetes. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato dëshmi, (*Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, Appl. Nr 13071/87, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 3, të 10 korrikut 1991*).
35. Fakti se parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë për të ngritur një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës (*Shih, mutatis mutandis, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, Appl. nr. 5503/02, MezoturTiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005*).
36. Në këto rrethana, parashtruesi nuk ka mbështetur me prova pretendimet e tij dhe as shkeljen e nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk tregojnë se Gjykata Supreme ia ka mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
37. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hedhet poshtë si e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, si dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2012, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani